

Përmes bashkëpunimit teknik dhe ndihmës me grante, JICA është aktive në fushat e infrastrukturës mjedisore dhe avancimin e kapaciteteve, si dhe në harmonizimin e bashkëpunimit ndëretnik midis komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

## PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË KONTROLLIT TË NDOTJES SË AJRIT NË KOSOVË

Skema: **Bashkëpunimi teknik**  
 Periudha e projektit: **Tetor 2017 - Shtator 2020**  
 Organizata partnere: **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MESP)**

Ndotja e ajrit po bëhet një çështje serioze në Kosovë, ndërsa ekziston një shqetësim në rritje i njerëzve për shëndetin. Për të adresuar këtë çështje, JICA, së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, po zbatojnë projektin për të përmirësuar kapacitetin e Ministrisë dhe agjencive përkatëse për matje dhe kontroll më të mirë të ndotjes së ajrit. Si pjesë e projektit, JICA ka dhuruar institutit Hidrometeorologjik të Kosovës 100 pajisje teknike për matjen e gazrave shkarkuese dhe matjen e cilësisë së ajrit.



Trajnimi për Kromatograf ION

## PROJEKTI PËR AVANCIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA

Skema: **Grante**  
 B/S: **Mars 2011**  
 Organizatat partnere: **Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit, Ndërmarrja Publike "Ekoregjioni" dhe Ndërmarrja Publike "Pastrimi"**

Përkeqësimi i shëndetit publik për shkak të shërbimit të pamjaftueshëm të mbledhjes së mbeturinave ka qenë një çështje serioze në Kosovë, veçanërisht në zonat urbane si Prishtina, kryeqyteti dhe Prizreni, qyteti i dytë më i madh. Projekti ka kontribuar në përmirësimin e

sistemit të depozitimit të mbetjeve publike në Prizren dhe disa komuna në rrethinën e Prizrenit duke shpërndarë rreth 40 kamionë të rinj kompaktor ndërmarrjeve komunale përkatëse.



Takimi në komunitet – implementimi i sistemit të ri të grumbullimit të mbetjeve



Monitorimi i kompostimit

## PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS (RTK)

Skema: **Bashkëpunimi teknik**  
 Periudha e projektit: **Tetor 2015 - Prill 2019**  
 Organizata partnere: **Radio Televizioni i Kosovës (RTK)**

Kanë kaluar 20 vjet nga përfundimi i konflikteve në Kosovë, por ende ekziston nevoja për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike. Për të nxitur bashkëpunimin, JICA ka mbështetur transmetuesin e shërbimit publik të Kosovës, Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në prodhimin dhe transmetimin e emisioneve informative, të prodhuara bashkërisht nga një ekip multietnik. Ekipi ka krijuar një program informativ i cili transmetohet, të quajtur "UMAMI", ndërsa emrin e ka marrë nga fjala japoneze për shije të këndshme, e cila po transmetohet. I bazuar në konceptin e bashkëpunimit ndëretnik, UMAMI është dokumentar hulumtues i cili mbulon tema të ndryshme nga të dy perspektivat. Emisioni transmetohet me titra në gjuhën shqipe dhe serbe.



Stafi shqiptar dhe serb duke punuar së bashku në zhvillimin e programit

## TRAJNIMI MBI AVANCIMIN E NJOHURIVE TEKNIKE DHE KAPACITETEVE PËR KONTROLLIN E SIGURISË SË USHQIMIT

Skema: **Bashkëpunimi teknik (Trajnimi në vendi e tretë)**  
 Periudha e projektit: **Shtator 2017- Tetor 2020**  
 Organizata partnere: **Agjencia Kosovare për ushqimin dhe veterinarinë (KFVA)**

Forcimi i kapaciteteve të sektorit bujqësor është vendosur si prioritet në Kosovë. Në lidhje me këtë, është theksuar përmirësimi i produktivitetit dhe cilësisë së produkteve në sektorin e bujqësisë, si dhe rritja e konkurrencës dhe përshtatja me standardet e BE-së. Në veçanti, shqetësimi për sigurinë ushqimore është një nga qëllimet e përgjithshme të Kosovës. Në bazë të diskutimit midis këshilltarit të JICA ODA dhe udhëheqësisë së lartë të agjencisë Kosovare për ushqimin dhe veterinarinë (AUV) të

cilët kanë marrë pjesë në programin e trajnimit JICA 2012, janë identifikuar nevojat e AUV-së për forcimin e kapaciteteve për të audituar procesin e kontrollit të sigurisë së ushqimit. Projekti ka për qëllim të themelojë një grup trainerësh për masat e kontrollit të sigurisë së ushqimit, të përqendruara posaçërisht në auditimin e zbatimit të Analizës së Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP) dhe parimeve të përgjithshme të higjienës ushqimore.



Kursi i dytë i organizuar në tetor 2019

# RRETH AGJENCISË JICA

Agjencia Japoneze për bashkëpunim ndërkombëtar (Japan International Cooperation Agency - JICA) ndihmon dhe mbështet vendet në zhvillim si agjenci zbatuese e Ndhmës zyrtare për zhvillim të Japonisë (ODA).

Në përputhje me vizionin e saj për të „udhëhequr botën me besim“, JICA mbështet zgjidhjen e çështjeve të vendeve në zhvillim dhe tranzicion duke përdorur mjetet më të përshtatshme të metodave të ndryshme ndihmëse dhe një qasje të kombinuar, të orientuar në rajon, vend dhe probleme.

JICA është e ngarkuar për administrimin e të gjitha ODA-ve, të tilla si bashkëpunimi teknik, bashkëpunimi financiar dhe investicional dhe granteve në mënyrë të integruar, përveç kontributeve në organizatat ndërkombëtare. JICA, agjencia më e madhe në botë për ndihmë bilaterale, operon në mbi 150 vende dhe rajone dhe ka rreth 90 zyra jashtë vendit.

## Bashkëpunimi teknik

Për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe formulimin e sistemeve administrative të vendeve në zhvillim, bashkëpunimi teknik përfshinë dërgimin e ekspertëve, sigurimin e paisjeve të nevojshme dhe trajnimin e stafit nga vendet në zhvillim në Japoni dhe vende të tjera. Planet e bashkëpunimit mund të përshtaten që të adresojnë një gamë të gjerë çështjesh.



Këshilltari për ndihmë



Projekti për zhvillimin e kapaciteteve të Radio Televizionit të Kosovës (RTK)



Trajnimi në Japoni: Zhvillimi në bashkësi me banorët lokal si aktorët kryesorë

## Bashkëpunimi financiar dhe investicional

### KREDI ODA

Kreditë ODA mbështesin vendet në zhvillim përmes financimit afatgjatë dhe mjeteve financiare koncesionale me interes të ulët. Kreditë ODA përdoren për infrastrukturë të proporcioneve të mëdha dhe forma të tjera të zhvillimit për të cilat nevojiten mjete të konsiderueshme.



Faza 2 e Projektit të sistemit të transportit masiv të shpejtë në Delhi (Indi)

### FINANCIMI INVESTICIONAL I SEKTORIT PRIVAT

JICA mbështet përshejtimin e rritjes ekonomike / sociale të vendeve në zhvillim nëpërmjet sektorit privat, përmes investimeve në borxhe dhe kapital për projektet e zhvillimit të ndërmarrjeve private.

## Grantet

Grantet janë burime financiare që i ipen vendeve në zhvillim të cilat kanë të ardhura të ulëta, pa detyrim shlyerje. Grantet përdoren për të përmirësuar infrastrukturën themelore siç janë shkollat, spitalet, objektet për furnizim me ujë dhe rrugët, si dhe për marrjen e kujdesit shëndetësor dhe mjekësor, furnizimin me pajisje dhe kërkesa të tjera.



Projekti për avancimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta

Ndhmë në katastrofa

Hulumtime

Bashkëpunimi përmes pjesëmarrjes së qytetarëve



# RRETH ZYRËS PËR BALLKAN E AGJENCISË JICA

E themeluar në vitin 2006 në Beograd, Serbi, Zyra për Ballkan e agjencisë JICA mbulon Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën \*, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Zyra për Ballkan e agjencisë JICA ofron ndihmë për rritje dhe stabilitet për vendet në rajon, duke punuar kryesisht në fushat e mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit të sektorit privat dhe konsolidimit të paqes.

\*Qeveria Japoneze e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur më 18 mars, 2008.

Përditësimi i fundit: Dhjetor 2019

## ZYRA PËR BALLKAN E AGJENCISË JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Qendra e biznesit USHQË,  
kati 17. Bulevardi Mihajla Pupina 6, 11070 Beograd, Serbi  
TEL: +381-(0)11-2200-750

FAKS: +381-(0)11-2200-761

[www.jica.go.jp/balkan/english/office/index.html](http://www.jica.go.jp/balkan/english/office/index.html)

Facebook: [www.facebook.com/jicabalkanoffice/](https://www.facebook.com/jicabalkanoffice/)

